



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

Sesioni V

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 14**

Prishtinë, 29.06.2015. në orën 13:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Mufera Sinik, Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Munguan: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Milka Vuletić, Saša Milosavljević dhe Slavko Simić.

Pjesëmarrës të tjerë: Ardiana Gashi dhe Senad Karaahmetović përfaqësues të OSBE-së , Marija Stanojević- përfaqësues i RTK-së- progami në gjuhën serbe, Amire Qamili- përfaqësuese e BIRN-t, Zijush Ahmeti- përfaqësues i Sekretariatit të KVZ, dhe Celal Iliaz- përfaqësues për media i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Stafi mbështetës i komisionit: Drita Çarkaxhiu, zyrtare e lartë ligjore

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Koordinator - Natasa Prica-Tishma, zyrtare e lartë ligjore - Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Mufera Sinik, zëvendëse e dytë e kryetarit të komisionit.

Në mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26.05.2015;**
- 3. Rishqyrtimi i Planit të punës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Mufera Sinik – konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26.05.2015.

Zëvendëskryesuesja – konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 26.05.2015, pa vërejtje.

3. Rishqyrtimi i Planit të punës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015.

Zëvendëskryesuesja – tha se Komisioni për gjashtëmujorin e parë, nuk ka arritur ti realizoj aktivitetet e planifikuara të cilat janë parapar me Planin të Punës, për vitin 2015. Me qëllim që në periudhën e ardhshme të realizohen këto aktiviteteve është e nevojshme të bëhen disa ndryshime dhe plotësime për përmirësimin e këtij plani.

I ftoj anëtarët e Komisionit që në këtë drejtim, të ofrojnë opinionet e tyre.

Veton Berisha - Kur bëhet fjalë për zbatimin e Planit të Punës për gjashtë muajt e parë ne jemi të vetëdijshëm se është bërë shumë pak. Konsideron se ne duhet të jemi më të angazhuar dhe më produktive në periudhën gjashtëmujore të dytë dhe të përqendrohemi në realizimin e çështjeve nga gjashtëmujori i parë.

Ai kishte vërejtje lidhur me formimin e grupeve punuese të cilat nuk janë funksionale. Në veçanti grupi punues lidhur me monitorimin e Ligjit për Shërbimin Civil, neni 11, kryetar të cilit jam unë, ka probleme për arsye të mungesës së kuorumit. Prandaj, nuk janë realizuar vizitat e planifikuara në rajonet ku jetonë komuniteti jo-shumicë. Gjithashtu, grupi punues ka propozuar që në një mbledhjet të Komisionit të ftohet ministri e Administratës Publike, z Mahir Yagcilar, ndërsa deri tani nuk është realizuar ky propozim.

Mendon se janë të krijuara të gjitha kushtet për zbatimin e planit të punës dhe nuk ka arsye të mos funksionojmë si komision. Kjo qasje e punës duhet të ndryshohet dhe propozoi që kryetarja të iniciojë procesin përpara. Ne duhet të kemi vullnet të mirë nga se bartin përgjegjësi për zhvillimin e proceseve për të gjitha komunitetet.

Danush Ademi – Mendoj se duhet të rishqyrtojmë planin e punës që të përshpejtohen realizimi i proceseve të planifikuara për vizitë. Çështjet e planifikuara për gjashtëmujorin e parë e të cilat nuk janë realizuar duhet të barten në pjesën tjetër të vitit. Ky është një komision i rëndësishëm dhe mendon se duhet të ketë më angazhime dhe të vazhdojmë të punojmë.

Qerim Bajrami – ka vërejtje se komisioni nuk ka qenë aktive në realizimin e aktiviteteve të planifikuara sipa planit të punës, përveç ligjeve të cilat kemi qenë të obliguar ti përkrahim që të njejtat të procedohen në votim të mëtejshëm në Kuvend.

Planin e punës ishte me shumë aktivitete të mira, por për fat të keq asnjëri prej tyre nuk është realizuar. Ai pajtohet me deputetin Ademi që të reduktohet plani i punës dhe njëherë propozoi që në mbledhjen e ardhshme të komisionit, bashkë me administratën dhe me ndihmën e OSBE-së, të përpunohet një version pak më i shkurtër. Pra, ne kemi nevojë për një seriozitet më të madh dhe çasje të përkushtuar në punë, me qëllim të realizimit të planit me aktiviteteve të parapara të punës.

Rustem Berisha – pajtohet me diskutimet e anëtarëve të komisionit që të ketë një qasje më serioze në punë me qëllim që komisioni të jetë më funksional. Konsideron se duhet të përpiqemi të ndryshohet puna në komision e cila do të kenë efikasitet më të mirë dhe më produktiv.

Agim Kikaj – kemi një plan të thukur, por për fat të keq kemi mbetë prapa në zbatueshmërinë e tij. Para së gjithash duhet të ketë një vullnet të mirë në lidhje me punën për të cilën ne jemi përgjegjës

Fisnik Ismaili – shumë është thënë dhe unë pajtohem se ne nuk kemi bërë mjaft për këtë. Ju duhet të ri-zhvilluar planin dhe të vazhdojnë të punojnë dhe të marrin vendime pa pritur.

Në bazë diskutimeve të paraqitura, Komisioni nxorri këtë:

Përfundim

Obligohet kryetarja e Komisionit, zëvendësit e saj, sekretariati i Komisionit dhe partneri OSBE-ja që të rishikojnë Planin e punës për gjashtëmujorin e parë me ndryshimet dhe plotësimet e Planit të punës për gjashtë mujorin e dytë për vitin 2015.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Nënkryetare e dytë e Komisionit

Mufera Sinik